



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____/2021

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.110/2018, “PËR NOTERINË”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

VENDOSI:

Në ligjin nr. 110/2018, “Për noterinë”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pas shkronjës “a” shtohet shkronja “a/1” me këtë përmbajtje:

“a/1) “Integriteti dhe besueshmëria” është mungesa e të dhënave, fakteve ose rrethanave të besueshme për përfshirjen e të interesuarit, kandidatit për noter, zëvendësnoterit ose noterit në kryerjen e veprimeve ose mosveprimeve që përbëjnë një nga veprat penale të parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, si dhe mungesa e kontakteve të papërshtatshme me një person të përfshirë në krimin e organizuar.”

2. Pas shkronjës “b” shtohet shkronja “b/1” dhe “b/2” me këtë përmbajtje:

“b/1) “Kontakt i papërshtatshëm” është mbajtja e lidhjeve të qëndrueshme nëpërmjet takimeve, komunikimit elektronik ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi të qëllimshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk kryhet për shkak të ushtrimit të detyrës ose për shkak të lidhjeve të ngushta familjare.

“b/2) “Lidhje të ngushta familjare” është rrethi i personave që kanë marrëdhënie familjare me kandidatin për noter, zëvendësnoterin ose noterin, i përbërë nga bashkëshorti, bashkëjetuesi, fëmijët, fëmijët e fëmijëve, prindërit, vëllezërit e motrat dhe fëmijët e vëllezërve e të motrave.

3. Pas shkronjës “d” shtohet shkronja “d/1” me këtë përmbajtje:

d/1) “Person i përfshirë në krimin e organizuar” është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Personi konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar edhe kur:

a) procedimi penal i filluar ndaj tij pushohet nga organi procedues për shkak të vdekjes, ose sepse nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet;

b) deklarohet i pafajshëm nga gjykata pasi vepra penale është kryer nga një person, që nuk mund të akuzohet ose dënohet.

Neni 2

Në nenin 5, bëhen këto shtesa:

1. Pas shkronjës “b” shtohet shkronja “b/1” me këtë përmbajtje:

“b/1) të ketë integritet dhe besueshmëri;”

2. Pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “ç/1” me këtë përmbajtje:

“ç/1) të mos jetë përfshirë në listën e personave të shpallur sipas legjislacionit në fuqi për masat kundër financimit të terrorizmit.”

Neni 3

Në nenin 6, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. I interesuari që përmbush kriteret e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “b/1”, “c”, “ç”, “ç/1” dhe “d”, të nenit 5, të këtij ligji, ka të drejtë të marrë pjesë në provimin e pranimit në formimin fillestar.”

2. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Qendra e Trajnimit administron shprehjet e interesit të të interesuarve si dhe dokumentacionin që është bashkëlidhur dhe ia përcjell ato Ministrisë së Drejtësisë”.

3. Pas pikës 5, shtohet pika 5/1, 5/2 dhe 5/3 me këtë përmbajtje:

5/1. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton plotësisht përmbushjen e kriterëve të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “b/1”, “c”, “ç”, “ç/1” dhe “d”, të nenit 5, të këtij ligji, nuk është i plotë, i saktë, ose ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e tij, Ministria e Drejtësisë mund të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë nga personi i interesuar ose nga çdo organ publik.

5/2. Rregulla më të hollësishme mbi paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimin të kriterëve ligjore përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

5/3. Pas verifikimit të plotësimin të kriterëve ligjore, Ministria e Drejtësisë i përcjell Dhomës dhe Qendrës së Trajnimit listën e të interesuarve që përmbushin kriteret e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “b/1”, “c”, “ç”, “ç/1” dhe “d”, të nenit 5, të këtij ligji.”

Neni 4

Në nenin 8, bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Në pikën 1, pas shkronjës “b”, shtohet shkronja “b/1” dhe pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “ç/1”.

2. Në pikën 8, pas togfjalëshit “rregulla më të hollësishme lidhur me” shtohet togfjalëshi “verifikimin dhe plotësimin e kriterëve ligjore si dhe”

Neni 5

Në nenin 9, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“1. Kandidati për noter, pas përfundimit me sukses të formimit fillestar të detyrueshëm 1- vjeçar dhe pas trajnimit praktik 2-vjeçar si kandidat për noter pranë një noteri, ka të drejtë të hyjë në provimin e kualifikimit për noter, nëse përmbush kushtet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “b/1”, “c”, “ç”, “ç/1” dhe “d”, të nenit 5, të këtij ligji.

2. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1, 1/2 dhe 1/3 me këtë përmbajtje:

“1/1. Rregulla të hollësishme mbi paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit për provimin e kualifikimit për noter, si dhe verifikimin e plotësimin të kriterëve ligjore përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

1/2. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton plotësisht përmbushjen e kriterëve të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “b/1”, “c”, “ç”, “ç/1” dhe “d”, të nenit 5, të këtij ligji, nuk është i plotë, i saktë, ose ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e tij, Ministria e Drejtësisë mund të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë nga kandidati për noter ose çdo organ publik.

1/3. Ministri urdhëron ndalimin e pjesëmarrjes në provimin e kualifikimit të çdo kandidati për noter që nuk përmbush kushtet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “b/1”, “c”, “ç”, “ç/1” dhe “d”, të nenit 5, të këtij ligji.”

Neni 6

Në nenin 17, pas pikës 4, shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

“5. Strukturat përgjegjëse të ministrisë së Drejtësisë përditësojnë dhe kontrollojnë regjistrin me “listën e personave të shpallur”, sipas legjislacionit në fuqi për masat kundër financimit të terrorizmit.

Neni 7

Në nenin 21, bëhen shtesat si më poshtë:

1. Në pikën 1, pas shkronjës “e” shtohen shkronjat “e/1, e/2, e/3” me këtë përmbajtje:

e/1) kur pranohet kërkesa e autoritetit përgjegjës, për revokimin e licencës së noterit, në përputhje me nenin 26 të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar,

e/2) vërtetohet që nuk ka integritet dhe besueshmëri;

e/3) përfshihet në listën e personave të shpallur sipas legjislacionit në fuqi për masat kundër financimit të terrorizmit;

Neni 8

“Neni 21/1

Procedura e heqjes së licencës

Në çdo rast, përpara se Ministri i Drejtësisë të vendosë heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 21, të këtij ligji, kryen një hetim administrativ në përputhje me rregullat e caktuara në Kodin e Procedurës Administrative.

Neni 9

Në nenin 47, shtohen pika 3 dhe 4, me këtë përmbajtje:

“3. Në seancë dëgjimore para Bordit Disiplinor:

a) ministri i Drejtësisë ose përfaqësuesi i tij, paraqet argumentet që shkelja disiplinore është kryer dhe propozon masën disiplinore që duhet të merret;

b) noteri ose zëvendësnoteri ose edhe përfaqësuesi i tij, paraqet argumentet mbrojtëse.

4. Përmbajtja e parashtrimeve me shkrim nuk përsëritet gjatë seancës dëgjimore.”

Neni 10

Në nenin 56, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Paragrafi i parë numërohet me numrin 1.

2. Në paragrafin e parë, shkronja “a” ndryshohet si më poshtë vijon:

“a) kur vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga noteri ose zëvendësnoteri dëmton rezultatin e hetimit ose procedimit disiplinor, pengon konkluzionin e tij të drejtë ose të rregullt, ose cënon figurën dhe integritetin e profesionit të noterit.

3. Pas pikës 1, shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

“2. Noteri ose zëvendësnoteri mund pezullohet përkohësisht nga detyra me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, kur:

a) merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje ose për një veprë penale që cenon figurën dhe integritetin e profesionit të noterit;

b) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një veprë penale;

c) ekziston dyshimi i arsyeshëm që noteri ose zëvendësnoteri nuk ka integritet dhe besueshmëri.

Neni 11

Në nenin 57, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Paragrafi i parë i nenit 57 numërtohet me numrin 1, si dhe, pas togfjalëshit “i noterit ose zëvendësnoterit, sipas” shtohet togfjalëshi “pikës 1, të”.

2. Pas pikës 1, të nenit 57, shtohet pika 2, me këtë përmbajtje:

“2. Pezullimi nga detyra i noterit ose zëvendësnoterit, sipas pikës 2, të nenit 56, të këtij ligji, mund të vendoset nga Ministri i Drejtësisë:

a) me nismën e vet;

b) mbi bazën e njoftimit, sipas parashikimeve të nenit 58, të këtij ligji.”

Neni 12

Në nenin 58, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në titull, pas togfjalëshit “Bordin Disiplinor” shtohet togfjalëshi “dhe Ministrin e Drejtësisë”.

2. Në pikën 1 të nenit 58, pas togfjalëshit “Bordin Disiplinor” shtohet togfjalëshi “ose Ministrin e Drejtësisë”.

3. Në pikën 2 të nenit 58, togfjalëshi “Bordin Disiplinor” zëvendësohet me togfjalëshin “Ministrin e Drejtësisë”.

4. Në pikën 2, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) marrin dijëni për të dhëna, fakte ose rrethana të besueshme që noteri ose zëvendësnoteri nuk ka integritet dhe besueshmëri;

Neni 13

Në nenin 59, pika 1, ndryshohet si më poshtë:

“1. Vendimi për pezullimin nga detyra, sipas parashikimit shkronjës “a”, dhe shkronjës “b” të pikës 2, të nenit 56, të këtij ligji, merret nga Ministri i Drejtësisë menjëherë nga paraqitja e kërkesës ose e informacionit. Në rastet e pezullimit, sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1 si dhe shkronjës “c” të pikës 2 të nenit 56, të këtij ligji, vendimi merret brenda 15 ditëve.”

Neni 14

Në nenin 60, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 1, ndryshohet si më poshtë:

1. Pezullimi, sipas pikës 1 dhe 2, të nenit 56, zgjat për aq kohë sa ekzistojnë arsyet për të cilat është urdhëruar, por në çdo rast jo më pak se:

a) deri në përfundimin e hetimit ose procedimit disiplinor, në rastin e parashikuar në pikën 1, shkronja “a”, të këtij neni;

b) deri në pagimin e kuotës ose tarifave përkatëse, në rastin e parashikuar në pikën 1, shkronja “c”, të këtij neni;

c) deri në pushimin e çështjes penale ose në dhënien e një vendimi të formës së prerë, në rastin e parashikuar në pikën 2, shkronja “a”, të këtij neni;

ç) deri në përfundimin e periudhës së arrestit në burg ose arrestit në shtëpi, në rastin e parashikuar në pikën 2, shkronja “b”, të këtij neni;

d) deri në përfundimin e hetimit administrativ, në rastin e parashikuar në pikën 1, shkronja “b” dhe pikën 2, shkronja “c”, të këtij neni.

2. Pika 2, pas togfjalëshit “Bordi Disiplinor” shtohet togfjalëshi “ose Ministri i Drejtësisë”

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYETARI

GRAMOZ RUÇI